

KAPITULLI 78

PLUMBI DHE ARTIKUJT PREJ TIJ

Shënim

1. Në këtë Kapitull shprehjet e mëposhtme kanë kuptimin e dhënë bashkangjitur tyre:

(a) Shufra dhe shkopinj:

Produkte të petëzuara, të stampuara, të tërhequra apo të farkëtuara, jo në spirale, të cilat kanë një seksion kryq uniform solid gjatë gjithë gjatësisë së tyre në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndëshit baras brinjor apo të shumëkëndëshit të rregullt konveks (përfshirë "rrethet e dystuar" dhe "drejtkëndëshat e modifikuar", prej të cilëve dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele). Produktet me seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë katrorin), trekëndësh apo shumëkëndësh mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre. Trashësia e produkteve të tillë të cilët kanë një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë "drejtkëndëshin e modifikuar") i kalon një të dhjetat e gjerësisë. Shprehja gjithashtu përfshin produktet e derdhura apo të shkrira, të formave dhe dimensioneve të njëjta, të cilët kanë qenë vazhdimisht të punuara pas përpunimit (ndryshe nga thjesht zbulurim apo heqje të bigorit), me kusht që ato nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(b) Profile:

Produkte të petëzuara, të tërhequra, të farkëtuara apo të formuara, në spirale apo jo, të një seksioni kryq uniform gjatë gjithë gjatësisë së tyre, të cilët nuk përputhen me ndonjë nga përcaktimet e shufrave, shkopinjeve, telave, pllakave, fletave, shiritave, krisafeve, tubave apo tubacioneve. Shprehja gjithashtu përfshin edhe produktet e derdhura apo të shkrira, të formave të njëjta, të cilët kanë qenë të punuara vazhdimisht pas përpunimit (ndryshe nga thjesht zbulurime apo heqje të bigorit), me kusht që ato si rrjedhim nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(c) Tela:

Produkte të petëzuara, të stampuara apo të tërhequra, në spirale, të cilët kanë një seksion kryq uniform solid gjatë gjithë gjatësisë së tyre në formë rrethore, ovale, drejtkëndëshe (përfshirë katrorin), trekëndësh baras brinjor apo të shumëkëndëshit të rregullt konveks (përfshirë "rrathët e dystuar" dhe "drejtkëndëshat e modifikuar", prej të cilëve dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele). Produktet me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë katrorin), trekëndësh apo shumëkëndësh mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre. Trashësia e produkteve të tillë të cilët kanë një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë "drejtkëndëshin e modifikuar") i kalon një të dhjetat e gjerësisë.

(d) Pllaka, fleta, shirita dhe krisafe:

Produkte me sipërfaqe të sheshtë (përveçse produkte të papërpunuara të kreut 7801), në spirale ose jo, të një seksioni kryq drejtkëndësh (përveçse katrorë) me ose pa qoshe të rrumbullakosura (përfshirë "drejtkëndëshin e modifikuar" prej të cilit dy anët e kundërta janë harqe konvekse, dy anët e tjera janë të drejta, të gjatësive të barabarta dhe paralele) të një trashësie uniforme, të cilët janë :

të formës drejtkëndësh (përfshirë katrorin) me një trashësi jo më tepër sesa një të dhjetën e gjerësisë,
të një formë përveçse drejtkëndëshe apo katrore, të çdo përmase me kusht që ato si rrjedhim nuk marrin karakterin e artikujve apo produkteve të krerëve të tjerë.

Kreu 7804 përfshin ndër të tjera, pllakat, fletat, shiritat dhe krisafet me struktura (psh, flaxha, brazda, katrore, çarje, butona, romba) dhe për të cilë produkte që kanë qenë të perforuara, të korruguara, të lustruara apo të veshura, me kusht që ato si rrjedhim nuk marrin karakterin e artikujve apo të produkteve të krerëve të tjerë.

(e) Tuba dhe tubacione:

Produkte të zgavruara, në spirale ose jo, të cilët kanë një seksion kryq uniform vetëm me një zgavër bashkangjitur tyre gjatë gjithë gjatësisë në formë të rrathëve, ovaleve, drejtkëndëshave (përfshirë katrorin), trekëndëshave baras brinjor apo shumëkëndëshave të rregullt konveks, dhe të cilët kanë një trashësi uniforme të mureve. Produktet me një seksion kryq drejtkëndësh (përfshirë katrorin), trekëndësh baras brinjor apo të shumëkëndëshit të rregullt konveks, të cilët mund të kenë qoshe të rrumbullakosura gjatë gjithë gjatësisë së tyre, do të konsiderohen gjithashtu si tuba dhe tubacione me kusht që seksioni kryq i brendshëm dhe i jashtëm janë baras qendrore dhe kanë të njëjtën formë dhe orientim. Tuba dhe tubacione të seksioneve kryq të sipërpërmendura mund të jenë të llustrosura, të veshura, të përkulura, të filetuara, të shpuara, të ngushtuara, të zgjeruara, të dhëna formë koni apo të përshtatura me flaxha, bokulla(kular) apo unaza.

Shënim i nën krerëve

Në këtë Kapitull shprehja "**plumb i rafinuar**" nënkupton:

Metal që përmban ndaj peshës të paktën 99,9 % plumb, me kusht që përmbajtja ndaj peshës të elementeve të tjerë nuk e kalon limitin e specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Elemente të tjera

Elementet		Përmbajtja limit në % ndaj peshës
Ag	Argjend	0,02
As	Arsenik	0,005
Bi	Bismuth	0,5
Ca	Kalcium	0,002
Cd	Kadmium	0,002
Cu	Bakër	0,08
Fe	Hekur	0,002
S	Sulfur	0,002
Sb	Antimon	0,005
Sn	Kallaj	0,005
Zn	Zink	0,002
Të tjera (psh, Te), secila		0,001

Kodi i mallrave	Përshkrimi	Njësitë plotësuese	Masa të politikës tregtare		Norma të detyrimit (%)	Norma preferenciale të detyrimit (%)	TVSH (%)	Norma të akcizës
			Importi	Eksporti				
7801	Plumb i papërpunuar:					CEFTA / MSA / TR		
7801 1000 00	Plumb i rafinuar	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 7	18	-
	- Të tjera:							
7801 9100 00	-- Që përmbajnë ndaj peshës antimon si element tjetër kryesor	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 8	18	-
7801 99	-- Të tjera:							
7801 9910 00	--- Për rafinim, që përmbajnë 0,02 % apo më shumë ndaj peshës argjend (plumb bullion)	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 8	18	-
7801 9990 00	--- Të tjera:	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 8	18	-
7802 0000 00	Mbetje dhe kthime plumbi	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 0	18	-
[7803]								
7804	Pllaka, fleta, shirita dhe krisafe plumbi; pluhura dhe fetëza plumbi:							
	-Pllaka, fleta, shirita dhe krisafe:							
7804 1100 00	-- Fleta, shirita dhe krisafe të një trashësie (përjashtojë çdo prapa vënie) jo më tepër sesa 0,2 mm	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 8	18	-
7804 1900 00	-- Të tjera	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 3 / TR : 8	18	-
7804 2000 00	- Pluhura dhe fetëza	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 0	18	-
[7805]								
7806 00	Artikuj të tjerë prej plumbi:							
7806 0010 00	- Kontenierë me një veshje plumbi anti-rrezatim, për transportin apo ruajtjen e materialeve radioaktive	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 0	18	-
7806 0080 00	- Të tjera	-	-	-	10	CEFTA : 0 / MSA : 0 / TR : 0	18	-